



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 22 mars 2011
Nr. ref.: RK 106/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 101/10

Parashtruesi

Ismet Hebibi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. I. Nr. 165/2004, të 9 nëntorit 2004**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Ismet Hebibi, me banim në Junik

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. Nr. 165/2004, të 9 nëntorit 2004.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi konsideron se i është shkelur e drejta e tij e punës dhe e drejta për kompensim, siç parashihet me ligj.
4. Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese ta kthejë rastin e tij në rigjykim, duke pohuar që Ministria e Shëndetësisë, QMF “Adem Ukëhaxhaj” dhe QMF “Dr. Ali Hoxha” në Junik ia kanë shkelur të drejtat e tij dhe nuk kanë vepruar në mënyrë ligjore.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 36 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e parashtrroi kërkesën pranë Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese më 11 tetor 2010.
7. Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Supreme më 19 janar 2011 se parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.
8. Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Gjykata Supreme.
9. Më 21 shkurt 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues Altay Suroy, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga Almiro Rodrigues (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Qendrën Mjekësore në Deçan në cilësinë e mjekut të praktikës së përgjithshme. Më 17 shtator 1992, me Vendimin nr. 126 të Qendrës Mjekësore në Deçan parashtruesit iu ndërpre marrëdhënia e punës.
11. Më 12 shkurt 2001, Aktgjykimi C. I. Nr. 18/2000, i Gjykatës Komunale të Deçanit, e anuloi Vendimin e Qendrës Mjekësore në Deçan, Nr. 126, të 17 dhjetorit 1992, dhe e detyroi të paditurën (dmth. Qendrën Mjekësore në Deçan) ta rikthente parashtruesin në marrëdhënie të punës. E paditura gjithashtu u detyrua t'i kompensonte shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 60 markash gjermane.
12. Më 9 korrik 2001, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Pejës, Ac. Nr. 65/2001, e hodhi poshtë ankesën e Qendrës Mjekësore “Adem Ukëhaxhaj” dhe e konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Deçanit, C. Nr. 18/2000, të 12 shkurtit 2001.
13. Më 28 dhjetor 2001, parashtruesi parashtrroi revizion pranë Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin kërkonte anulimin e Aktgjyimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe caktimin e kompensimit të të ardhurave të tij për periudhën prej 1 nëntorit 1991 deri më 31 shtator 2001.

14. Më 9 nëntor 2004, Gjykata Supreme e Kosovës shqiptoi Aktgjykimin Rev. I. Nr. 165/2004 për rastin e parashtruesit, e hodhi poshtë si të pabazë Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Pejës, Ac. nr. 108/2003, të 13 korrikut 2004, dhe e hodhi poshtë revizionin e parashtruesit.
15. Më 14 shkurt 2005, parashtruesi parashtrroi kërkesë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës për kompensimin e të ardhurave personale.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi ankohet që ligjërisht ishte dëmtuar, ndjekur penalisht dhe manipuluar nga një drejtësi arbitrare. Ai pohon që kishte të drejtë të kthehej në punë dhe për kompensim të të ardhurave personale nga Ministria e Shëndetësisë dhe Qendra e Mjekësisë Familjare "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan, si dhe nga Qendra e Mjekësisë Familjare "Dr. Ali Hoxha" në Junik.

Vlerësimi i pranueshmërisë të kërkesës

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
18. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata vëren që parashtruesi ankohet për Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 165/2004, të 9 nëntorit 2004. Kjo do të thotë që kërkesa ka të bëjë me ngjarje që kanë ndodhur para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
19. Prandaj, rezulton që kërkesa nuk është në përputhje "*ratione temporis*" me dispozitat e Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Jasiüniené kundër Lituanisë, Kërkesa Nr. 41510/98, Aktgjykimet e GJEDNJ-së të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003), dhe nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, siç parashihet me nenin 56 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe Rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri,


VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani